



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 23.05.2023

Nr: 132

Ora: 14:05

**VENDIM**

**PËR KTHIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 72, TË DEPOZITUAR NË KQZ NË DATËN 22.05.2023  
NGA Z. LAME JAUPAJ**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 23.05.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Z. Lame Jaupaj, përfaqësuar nga z. Fabian Topollari

**OBJEKT:** Pavlefshmëria e tabelave përmbledhëse për të gjitha QV-të e KZAZ nr. 78, bashkia Memaliaj, rinumërimi i kutive të këshillit bashkiak KZAZ nr. 78.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,



## VËREN:

Z. Lame Jaupaj ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 72 regj., datë 22.05.2023.

Në mbledhjen e datës 23.05.2023, ora 14:05, pas relatimit të z. Ilirjan Rusmali u konstatua se kërkesa ankimore nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, pasi është paraqitur me të meta. Konkretisht:

**Së pari:** Ankuesi, si individ që kandidon për anëtar në këshillin bashkiak në listën shumëemërore të subjektit zgjedhor "Aleanca Progresiste LZHK" nuk legjitimohet për të bërë kërkesë ankimore pranë KAS, për arsye se nuk mbart cilësinë e subjektit zgjedhor. Këtë cilësi e ka vetëm subjekti politik "Aleanca Progresiste LZHK" dhe në këto kushte, ankimuesit i mungon autorizimi i posaçëm nga kjo parti për ta përfaqësuar atë pranë KQZ-së. Neni 130, pika 1 shkronja "b" e parashikon legjitimitetin e ankuesit, si element thelbësor për pranimin e kërkesës ankimore.

**Së dyti:** Në ankim nuk është referuar vendimi/vendimet që ankimohet, sipas parashikimit të nenit 126, pika 1, shkronja "b" të Kodit Zgjedhor. E drejta e ankimit parashikon ankimin ndaj vendimit të KZAZ-së për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse. Ndaj këtij vendimi, ankimi mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit dhe/ose pavlefshmërinë në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të K. Zgjedhor, ndërkohë që ankuesi ka kërkuar rinumërim.

**Së treti:** Ankimi i paraqitur në KAS nuk është shoqëruar me asnjë provë dhe nuk tregon asnjë provë që kërkohet të merret gjatë procesit të shqyrtimit të ankimit, në funksion të zgjidhjes së çështjes, sic parashikohet në nenin 126, pika 1, shkronja "dh" të Kodit Zgjedhor. Pas saktësimit të objektit të kërkesës ankimore, pala ankimuese duhet të riorganizojë provat në përputhje me këtë objekt.

**Së katërti:** ankuesi nuk ka depozituar së bashku me ankimin, një përshkrim më të detajuar dhe të saktë të fakteve, argumenteve dhe dispozitave ligjore, ku mbështetet ankimi sipas parashikimit të nenit 126, pika 1 shkronja "d" të Kodit Zgjedhor.

Në bazë të nenit 129, pika 1, të Kodit Zgjedhor, KAS për çdo kërkesë ankimore të regjistruar bën verifikimin e ekzistencës së elementeve të formës sipas nenit 126 të Kodit Zgjedhor dhe të

elementeve të përcaktuara në nenin 130 të po këtij Kodi. Në kushtet kur kërkesa ankimore objekt i kësaj procedure të plotësimit të formës dhe përmbajtjes nuk i plotëson kushtet e shkronjave “b”, “d” dhe “dh” të pikës 1, të nenit 126, si dhe të shkronjës “b”, të pikës 1 të nenit 130 të Kodit Zgjedhor, ajo duhet t’i kthehet për plotësimin e elementeve të formës, sipas përcaktimeve të cituara si më sipër.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “c” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

#### **V E N D O S I:**

1. Kthimin e kërkesës ankimore nr. 72, datë 22.05.2023 për plotësim të elementëve të formës.
2. Seanca paraprahe do të zhvillohet më datë 24.05.2023, ora 14:40.
3. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palës në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit paraparak, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

U shpall sot më datë 23.05.2023.

<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	- <b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	- <b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	- <b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	- <b>Anëtar</b>